



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

WWW.UMED.EDU.AL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2703/Prot.
10

Tiranë, më 30 /09 /2022

VENDIM

Nr. 75, datë 30.09.2022

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK TË UMT-SË NR. 33, DATË 17.03.2020 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”, I NDRYSHUAR

Në bazë të nenit 3, 38, 61 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”” i ndryshuar, të Statutit të UMT-së, Senati Akademik pas propozimit të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik të UMT-së me shkresën nr. 2666 prot., datë 29.09.2022 “Propozim për disa amendime në rregulloren “Për fitimin e titujve akademik ...” dhe diskutimit sipas rendit të ditës,

VENDOSI:

1. Në Rregulloren “Për fitimin e titujve akademikë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” të miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 33, datë 17.03.2020, “Për fitimin e titujve...” të ndryshohet neni 8, pika 1/a dhe neni 15, pika 1/a si më poshtë:

Neni 8

Monografia shkencore për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar”

1. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1 të nenit 6, sipas ekuivalentimit që vijon:
 - a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”, brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit.

Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës **si dhe konsiderohet e vlefshme vetëm nëse është e aprovuar nga Këshilli i Botimeve në UMT.**

Neni 15

Monografia shkencore për fitimin e titullit “Profesor”

1. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 14, sipas ekuivalentimit që vijon:
 - a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Profesor i asociuar” brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njëسيا bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës **si dhe konsiderohet e vlefshme vetëm nëse është e aprovuar nga Këshilli i Botimeve në UMT.**
2. Ngarkohet për zbatimin e kësaj Rregulloreje Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, Këshilli i Botimeve dhe njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare (web) të UMT-së.

